



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

---

Anr.18/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Skender Çoçaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Socijal Demokratska Unija, (SDU), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr.01/30-2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) të datës 08.01.2025 dhe Vendimi Nr.01/31-2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 08.01.2025, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.01.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa A.nr.18/2025 datë 10.01.2025 e Subjektit Politik Socijal Demokratska Unija, (SDU), me seli në Prizren, ANULOHEN Vendimi Nr.01/30-2025, i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, i datës 08.01.2025 2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, dhe çështja kthehet në rivendosje në KQZ.

#### A r s y e t i m

Me datën 10.01.2025 PZAP ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik Socijal Demokratska Unija (SDU) me seli në Prizren në të cilin pretendohet se KQZ gjatë shpërndarjes së komisionerëve në komuna, KQZ-ja ka bere zvogëlimin e jashtëzakonshëm të numrit të komisionerëve për partitë e komuniteteve te cilët kanë te drejtë e përfaqësimi sipas kushtetutës dhe Ligjit per Zgjedhjet ku shpërndarja e komisionerëve nuk është kryer ne baze te kriterave te drejta duke i trajtuar ne mënyre te barabartë si partitë parlamentare si ato jashtë parlamentare përkundër specifikave dhe te drejtave te tyre. E njëjta thekson se partitë kryesore kane ruajtur

numrin e tyre te komisionereve, ndërsa partitë e tjera përfshire ato të përfaqësuar ne kuvend janë prekur ndjeshëm nga kjo shpërndarje.

Parashtruesi i ankesës, kërkon të vepohet në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, të ju sigurohen të drejta të barabarta dhe pjesëmarrje të barabartë në zgjedhje. Me propozim që të anulohen vendimet e KQZ-së, nr.01/30-2025, për miratimin e përbërjes së ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi nr.01/31-2025, për miratimin e përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 08.01.2025, duke siguruar përfaqësim te drejtë në të gjitha vendvotimet, në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse, të siguroj që partitë e komuniteteve dhe partitë tjera parlamentare të mos dëmtohen.

KQZ-së, në përgjigje në Ankesë ka theksuar se, gjatë vendimmarrjes KQZ, është bazuar në nenin 74,75,76,77,78 dhe 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 20 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit si dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi Numërimi dhe Menaxhimi i VV.

KQZ, gjatë ndarjes së vendeve përtej neneve të lartcekura është angazhuar që gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes të përdorë një qasje gjithë përfshirëse sidomos për komunitetin jo shumicë duke i ndarë vende përtej prezencës së komuniteteve të caktuara në vendvotimet e ndryshme apo numrin e votave .

Gjatë këtij procesi janë marrë për bazë aktet ligjore të cilat përkufizojnë qartë detyrat dhe funksionet e anëtarëve të KVV, të shprehura në numër dhe funksione që nuk kalojnë numrin prej 5 anëtarëve në një KVV, mirëpo përtej këtij fakti KQZ në rastet e caktuara ka shtuar numrin e anëtarëve deri në 6 (gjashtë) anëtar më qëllim të përfshirjes edhe më të madhe të komuniteteve jo shumice në komunat përkatëse.

Bazuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovë mbi përbërjen e Kuvendit mbi bazën e së cilës 20 vende janë garantuar për komunitetin jo shumicë si dhe në të dhënat e fundit të Agjencisë se Statistikave të Kosovës për vitin 2024, janë bërë edhe vlerësimet adekuate në bazën e të cilave ka dal edhe përbërja e secilës KVV bazuar në numrin komuniteteve në ato komuna, për aq sa kjo ka qene e mundur të realizohet për faktin e kufizimit të numrit të anëtarëve në KVV që është deri në pesë (5) anëtar dhe rritja e këtij numër e pamundëson funksionimin e KVV gjatë ditës së zgjedhjeve.

Andaj, pretendimet e palëve ankuese mbi “zvogëlimin numrit e të KVV” nuk qëndrojnë për faktin se ndryshimet Ligjore dhe të akteve nënligjore tashme kanë përcaktuar qartë përbërjen dhe funksionet e secilit anëtar të KVV. Përqindja e votave të fituara qoftë në nivel qendror apo në nivel lokal, nuk është kriter i cili përcakton përbërjen e KVV në komunat përkatëse. I vetmi kriter ligjor që ka të bëjë është nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili thotë se Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e

katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë, ku edhe në këtë rast KQZ e ka anashkaluar këtë nen në disa raste, me qëllim të përfaqësimit sa më të madh të komuniteteve jo shumicë.

KQZ-ja, ka marrë për bazë edhe paragrafin 4 të nenit 77, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili i jep kompetencë KQZ-së që pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.

Andaj, në bazë të neneve të lartcekura, konsiderojnë se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës së subjektit politik ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara në bazë të nenit 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, ku parashihet që *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ. Ankesa shqyrtohet dhe vendoset nga PZAP brenda 72 orëve nga parashtrimi i saj"*, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se, me rastin e marrjes se vendimeve nga KQZ, Vendimi Nr.01/30-2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullorja Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit si dhe Rregullorja Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve.

Me dispozitën e nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që: *"Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë"*. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parashihet që: *"Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni"*.

Me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit parashihet që: *"KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse"*.

Paragrafi 2 i Rregullores parasheh që: “Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale”. Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore parasheh që: Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve”.

Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve parashihet që: ”KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal”.

Bazuar në shkresat e lëndës Paneli vlerëson se KQZ me vendimet e sipër theksuara nuk ka dhënë arsye se si është bërë caktimi i përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve, në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht si dhe Përbërja e Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, ndërsa kjo nuk është qartësuar as përmes përgjigjes në ankesë të bërë nga KQZ-ja. KQZ ka për obligim që ndarjen e tillë të bëjë sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore dhe ndarja të bëhet duke trajtuar në mënyrë të barabartë subjektet politike në bazë të kriterëve të përcaktuara, në mënyrë që përfshirja të jetë e tillë që të reflektoj pjesëmarrje të barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në garë elektorale, për këtë arsye Paneli ka vendosur që ti anuloj vendimet e atakuara duke kthyer çështjen në rivendosje në KQZ. Në rivendosje KQZ duhet që, bazuar në rregullat dhe kriteret e përcaktuara, duke respektuar parimin e barazisë dhe përfaqësimit për të gjithë që marrin pjesë në garë zgjedhore, të rivlerësoj çështjen e caktimit të përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve, në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht si dhe përbërjen e ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit.


Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e aprovuar ankesën si të bazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr.18/2025, datë 11.01.2025

Kryesues i Panelit

Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.